

Akt Themelimi I Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar “Natyra Import” SH.P.K.

Ne Elbasan, sot me datë 22.03.2021, në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, është themeluar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “Natyra Import” SH.P.K.

Parashikimet e këtij Statuti zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K).
Në këtë statut përfshihen:

- “Ligji” - është Ligji Nr.9901, dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i azhurnuar;
- “Statuti”- është Statuti i shoqërise;
- QKR” - Qendra Kombëtare e Regjistrimit në Shqipëri.

KREU I Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1. Sot me datë 22.03.2021, në themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Natyra Import” SH.P.K.

1.2. Kjo shoqëri themelohet nga ortaket e mëposhtëm:

- a. **Skërdi Berdica**, i biri i Skender Berdices lindur me 09/09/1978, në Shkoder, me shtetësi Shqiptare, mbajtes i kartës së identitetit me numër personal H80909069R.
- b. **Eltion Frasheri**, i biri i Mirgjin Frasherit lindur me 30/03/1978, në Sheqeras, Korçë, me shtetësi Shqiptare, mbajtes i kartës së identitetit me numër personal H80330097R.

Ortakët e lartpërmendur janë madhore dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar.

Neni 2

Selia

2.1. Shoqëria e ka selinë në Elbasan, Lagja Kongresi i Elbasanit, z.k. 8521, pasuria nr 13/142. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 3

Objekti

3.1. Shoqeria do te kryeje aktivitetin si me poshte:

Prodhim, perpunim, shperndarje fruta perime dhe eksport produktesh.

Neni 4

Kohezgjatja

4.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1. Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 (Njeqind mije) lekë, dhe eshte i perbere nga 2 kuota.

Vlera e nje kuote eshte 50.000 (Pesedhete mije) leke.

Kapitali i mesiperm nenshkruhet dhe shlyhet teresisht ne te holla nga ortakët e shoqerise, perkatesisht:

- a. **Skerdi Berdica**, zoteron 1 kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (Pesedhete mije) leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- b. **Eltion Frasheri**, zoteron 1 kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (Pesedhete mije) leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

5.2. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte ti kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i denimit.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

9.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

9.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
 - b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - ç) percaktimin e shperblimeve
 - d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 9.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

10.1. Shoqeria do te administrohet nga nje administrator.

Administrator i shoqerise do te jete **Z. Skerdi Berdica**, i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Perveç kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane QKB.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Neni 11

Kompetencat e Administratoreve

11.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

11.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndernjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

11.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

11.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 12

Pergjegjesite e Administratorit

12.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

12.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

12.3. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

12.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

12.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

12.3.3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane

realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

12.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

12.5. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

12.6. Administratori kate gjitha kompetencat per te vepruar nedarredhenie me te tretet ne emerte shoqerise, netegjitharrethanat, meperjashtim tekompentencave qeligiua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori ka te drejte te caktoj nje apo me shume perfaqesues te tij qe te mund te kryejne deri te njejtat funksione si administratori pa asnje limit, me prokure apo me autorizim, sipas ligjit.

Neni 13

Viti Financiar

13.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Prishja dhe likuidimi

14.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

14.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

14.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

14.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

14.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 15

Baza Ligjore


15.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

15.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Ngarkohet dhe autorizohet **Administratori**, per depozitim te akteve prane QKB.

ORTAKET

Skerdi Berdica



Eltion Frasheri

